



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



**ZGJEDHJET E JASHTËZAKONSHME PËR KRYETAR TË KOMUNAVE: MITROVICË E VERIUT,
ZVEÇAN, LEPOSAVIQ DHE ZUBIN POTOK, SI DHE ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PËR KUVENDET
E KOMUNAVE: ZVEÇAN DHE LEPOSAVIQ**

23 prill 2023

AFATI PËR AKREDITIMIN E VËZHguesve

Subjektet politike të certifikuar, OJQ-të, organizatat qeveritare dhe ndërqeveritare, organizatat ndërkombëtare të specializuara, të cilat merren me zgjedhjet dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, mediat si dhe përfaqësuesit e vendeve të huaja, mund të dorëzojnë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për t'u akredituar për vëzhgimin e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe zgjedhjet e parakohshme për kuvendet e Komunave: Zveçan dhe Leposaviq.

- a) Afatet për dorëzimin e kërkesës për akreditimin e OJQ-ve vendore dhe ndërkombëtare dhe mediave, fillon **më 10 mars 2023 dhe përfundon më 18 prill 2023.**
- b) Afati për akreditimin të subjekteve politike, fillon **më 10 mars 2023 dhe përfundon më 17 prill 2023.**

Vetëm vëzhguesve të akredituar do tu lejohet qasja në hapësirat ku organizohen zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunave: Mitrovicë e Veriut, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, si dhe zgjedhjet e parakohshme për kuvendet e Komunave: Zveçan dhe Leposaviq.

Formularët për akreditim mund t'i merrni në Zyrën për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike, apo në ueb-faqen e KQZ-së: www.kqz-ks.org

Për informata shtesë, mund të kontaktoni në tel. 038 200 81 010